

Termet e Referencës

Artist/e për të realizuar një mural me tematikë “Arsimi gjithëpërfshirës në Kosovë”

I. HYRJE

HANDIKOS, “Shoqata e paraplegjikëve dhe paralizës së fëmijëve të Kosovës” është krijuar si reagim ndaj gjendjes së vështirë në të cilën gjenden personat me aftësi të kufizuara në Kosovë, e themeluar nga dhe për personat me aftësi të kufizuara, me aktivitete të pandërprera që nga viti 1983. Si organizatë përfaqëson, përkrahë dhe punon për dhe me personat me aftësi të kufizuara përmes avokimit dhe lobimit. Ofron shërbime të ndryshme përmes rrjetit të shtrirë në gjithë Kosovën dhe promovon barabarësinë, jetën e pavarur dhe me dinjitet për të gjithë personat me aftësi të kufizuara.

II. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

HANDIKOS në partneritet me Save the Children në Kosovë është duke implementuar projektin “Handikos for Child Rights-H4CR”, i cili financohet nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Zhvillim (SIDA). Përmes këtij projekti HANDIKOS synon ngritjen e kapaciteteve dhe fuqizimin e fëmijëve me Aftësi të Kufizuara.

Grupi Avokues i Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara “Hëna” është grup jo formal i themeluar nga HANDIKOS që nga viti 2017, i cili që nga themelimi ka për mision të garantoj të drejtat e fëmijëve për fëmijët me aftësi të kufizuara. HËNA përfaqëson nevojat e fëmijëve në nivel lokal dhe qendror, për më tepër është aktivisht i përfshirë në të gjitha proceset e HANDIKOS.

III. OBJEKTIVA E DETYRËS

HANDIKOS kërkon të angazhojë një artist/e për të realizuar një mural përmes të cilit synohet të risë ndërgjegjësimin publik për edukimin gjithëpërfshirës në Kosovë.

Nga artisti/ja kërkohet:

Të krijohet një koncept artistik që reflekton të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara për edukim;
Të realizohet një mural publik në një lokacion të aksesueshëm në Prishtinë (të propozuar nga ekspert/ja), dhe të miratuar nga komuna.

IV. KUALIFIKIMI

- Artist/e me përvojë në art publik;
- Përvojë në projekte pjesëmarrëse me fëmijë;
- Njohuri mbi çështjet e aftësive të kufizuara dhe praktikat përfshirëse (konsiderohet përparësi).

V. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

Eksperti/ja i/e angazhuar do të jetë përgjegjës/e për:

- Hulumtim dhe konsultime me stafin e projektit dhe përfaqësuesit e Grupit Hëna;
- Hartimi i konceptit dhe prezantimi për miratim tek stafi i projektit dhe përfaqësuesit e Grupit Hëna;
- Propozim të hapësirës ku do të realizohet murali në Prishtinë;
- Realizimi i muralit me pjesëmarrjen aktive të fëmijëve.

VI. ANGAZHIMI I ESKPERTIT/ES

Eksperti/ja do të angazhohet me anë të një kontrate për shërbim me HANDIKOS. Angazhimi do të bëhet gjatë muajit Korrik/Gusht 2025 në bazë ditore, ku do të përfshihen aktivitetet e mëposhtme:

Detyra	Kohëzgjatja
Planifikimi dhe realizimi i muralit me tematikë Arsimi gjithëpërfshirës në Kosovë	7 ditë

VII. KUSHTET E PAGESËS

Pagesa e ekspertit/es do të bëhet sipas faturës përkatëse për kryerjen e shërbimeve, që do të lëshohet nga ai/ajo. Pagesa do të bëhet pas përfundimit të muralit.

HANDIKOS do të realizoj pagesën në Euro, shuma bruto për ditët e punës (nga të cilat do të ndalet tatimi në fitim dhe kontributi pensional sipas ligjeve në fuqi në Kosovë).

HANDIKOS rezervon të drejtën e negociimit të propozimit financiar.

VIII. PROCEDURA PËR APLIKIM

- Curriculum Vitae (CV) (max.3 faqe);
- Një koncept fillestar;
- Propozimi financiar.

Aplikacionet duhet të dorëzohen në formë elektronike në e-mail adresën: handikos@handi-kos.org
cc: nora.simitciu@handi-kos.org dhe antika.maksutaj@handi-kos.org

Ju lutem, shkruani në subjekt Aplikimi për "Artist/e për të realizuar muralin"

